



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
avokatipopullit.gov.al

Nr. 92 Prot.

Tiranë, 16/08 2023

Lënda: Kërkesë për informacion në lidhje me kandidatët nga rradhët e avokatisë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Drejtuar: Znj. Gentina SULA
Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit

Tiranë

E nderuar zj. Sula,

Avokati i Popullit në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është duke zhvilluar procedurat që lidhen me verifikimin paraprak nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc të plotësimit të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kriterëve profesionale dhe morale dhe renditjen e avokatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndër kompetencat specifike që i ngarkohen Avokatit të Popullit në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc janë edhe kompetencat e renditura në pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 31, si dhe në pikën 2, 3, 4, të nenit 129 të ligjit të sipërcituar.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 31 dhe pikës 3 të nenit 129, ku përcaktohet se: "*Për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, kryetari i Komisionit dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës*", del e nevojshme që të verifikohet pranë institucionit tuaj përmbushja e kriterit ligjor, të përcaktuar në germën ç, pika 3, të nenit 21 dhe germën g, pika 3, të nenit 119.

Në këto dispozita citohet se: "Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

- *Që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut të vitit 1991.*

Mbi bazën e listës së emrave të kandidatëve që kanë aplikuar nga rradhët e avokatisë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilat po i dërgojmë bashkëngjitur kësaj shkrese, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon bashkëpunimin tuaj për verifikimin sa më të shpejtë të kandidaturave perkatëse.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zenelaj



| |
|---|
| Emer Mbiemer |
| 1. Adrian Leka |
| 2. Alban Alimema |
| 3. Albana Tushe |
| 4. Altin Hazizaj |
| 5. Altin Shegani |
| 6. Andi Muratej |
| 7. Artan Reçi |
| 8. Bledar Bajri (Boshnjaku) |
| 9. Daniel Ndrekaj (Ndoka) |
| 10. Diana Dervishi |
| 11. Donata Lepenica (Selmanaj) |
| 12. Edison Hoxha |
| 13. Eduard Allamani (Reçi) |
| 14. Eduard Mullaraj |
| 15. Emiljano Hajrulla |
| 16. Entela Shehaj (Memishaj) |
| 17. Erind Germenji |
| 18. Erind Merkuri |
| 19. Eris Hysi |
| 20. Fatos Lazimi |
| 21. Ilir Alushi |
| 22. Juelda Lamce |
| 23. Julian Kola |
| 24. Klodian Gjermeni (Gjërmëni, Gjermëni) |
| 25. Margarita Kola (Lena) |
| 26. Mirela Murati (Aliçka) |
| 27. Nada Dollani |
| 28. Nertila Sadedini (Murati) |
| 29. Perparim Kalo |
| 30. Rezarta Abdiu |
| 31. Saimir Vishaj |
| 32. Saimir Kola |
| 33. Sokol Dedndreaj |
| 34. Valbona Greva |
| 35. Violanda Theodhori (Dhonato) |
| 36. Albens Tabaku |
| 37. Petrit Gaci |
| 38. Odise (Arben) Xhelita |